

TİK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 6725 Prot

Shkodër, më 27.3.2025

VENDIM

Nr. 122, datë, 27.3.2025

PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE TË LEJUARA PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E DATËS 11.05.2025 PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË.

Në mbështetje të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar neni 79, Udhëzimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Nr.6 ,datë,23.03.2021, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore" i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përcaktimin e vendeve publike të lejuara në territorin e Bashkisë Shkodër për afishimin e materialeve edukative zgjedhore dhe propagandistike nga subjektet zgjedhore në mënyrë proporcionale, hapësirë kjo që siguron shikueshmerinë publike.
2. Materialet propagandistike zgjedhore dhe sendet e lejuara për fushatë zgjedhore lejohen të afishohen vetëm deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës dhe jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit ,shtyllat e ndriçimit dhe mjetet që operojnë në transportin publik.
4. Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të..." (vijon emri i subjektit zgjedhor).
5. Subjektet zgjedhore duhet të njoftojnë me shkrim Kryetarin e Bashkisë për hapjen e zyrave zgjedhore me adresat e sakta të tyre, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve.

6. Partitë politike dhe subjektet zgjedhore duhet ti përmbahen dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe Udhëzimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe me mbarimin e fushatës zgjedhore, të marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.
7. Policia bashkiake ngarkohet me detyrë për të garantuar zbatimin ketij vendimi, për të mos lejuar, për të hequr menjëherë çdo material static përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendndodhje tjetër kur konstatohet që nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe Udhëzimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
8. Ky vendim i dërgohet për njohje Prefektit të Qarkut Shkodër dhe Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Shkodër.
9. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit dhe një kopje e tij i njoftohet Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve brenda 24 orësh..
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Benet BECI

